



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.21/2011
Prishtinë, më 19.07.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostić.

Munguan: Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi -USAID/Delotte; Ukë Gashi-ZPRK; Natyra Kasumi - KDI dhe Lejla Selimi - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet te datave 05 dhe 07.07.2011;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim te konformitetit;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-47 për masat mbrojtëse të importeve;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-48 për tregti me jashtë;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet te datave 05 dhe 07.07.2011

Procesverbalet nga mbledhjet te datave 05 dhe 07.07.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim te konformitetit

Kryetari – theksoj se sipas Rregullores së Punës së Kuvendit para leximit të parë të Projektligjeve, Komisionet funksionale shqyrtojnë në parim Projektligjet. Dhe kërkoj nga deputetët të paraqesin vërejtjet e tyre në parim. Njëkohësisht propozoj që për këto tri Projektligje që janë në shqyrtim në parim të këtë një Grup punues për shkak të lëndës që trajtojnë këto Projektligje.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim te konformitetit.

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim te konformitetit.

2. Arsytimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjeve: nr.04/L-39 për kërkesat teknike dhe vlerësim te konformitetit; nr.04/L-47 për masat mbrojtëse të importeve dhe Projektligji nr.04/L-48 për tregti me jashtë;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija raportuese, Hashim Deshishku, Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi anëtarë;*
- 3. Secili anëtarë i Komisionit sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit punues gjate punës së tij;*
- 4. Grupi punues ne bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim ne Komision.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-47 për masat mbrojtëse të importeve;

Kryetari – kërkoj nga deputetët të paraqesin vërejtjet e tyre në parim dhe të miratohet në parim.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-47 për masat mbrojtëse të importeve.

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-47 për masat mbrojtëse të importeve.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-48 për tregti me jashtë

Kryetari – po ashtu edhe për këtë pikë të rendit të ditës kërkoj deklaram në parim nga anëtarët e Komisionit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-48 për tregti me jashtë..

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-48 për tregti me jashtë..*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

6. Të ndryshme;

a) Takimi i Komisionit me ministrin Oldashi, ministër i Transportit të Republikës së Shqipërisë

Kryetari –i njoftoj deputetët për vizitën e delegacionit të Shqipërisë, respektivisht ministrit të Transportit z.Oldashi, që do ta ketë një takim me anëtarët e Komisionit për të premtën më datën 22.07.2011 në ora 11:00.

b) Mbledhja e radhës

Kryetari – i njoftoi deputetët së gjatë kësaj jave do të kemi edhe një mbledhje, për të miratuar Raportet me rekomandime për Projektligjet që do të dërgohen për lexim të dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit